



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 1133 Prot.

Lezhë, më 28.11.2020

Lënda : Mbi shfrytëzimin e paligjshëm të inerteve në shtratin e lumit Mat

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Tiranë

AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Tiranë

SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRËNDSHME DHE ANKESAT

Sheshi "Skënderbej", No.3, Tiranë

INSPEKTORIATIT KOMBËTAR TË MJEDISIT DHE TERRITORIT

Tiranë


Për dijeni: **MINISTRISË SË BRËNDSHME**

Tiranë

Në kuadër të shqetësimit për numrin e lartë të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e nxjerrjes së inerteve në shtratin e lumit Mat, ju informojmë se masakra mjedisore ndaj këtij baseni vazhdon të jetë prezente edhe në këto momente dhe nuk ka ndaluar për asnjë moment, edhe pse institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ka reshtur së adresuari problematikën e shkatërrimit mjedisor në institucionet ligjzbatuese dhe inspektuese.

Shfrytëzimi i paligjshëm i inerteve nga subjekte pa leje, përveçse ushtrohet hapur, pa u shqetësuar nga askush, deri më sot nuk jemi informuar nga institucionet përgjegjëse për verifikimin e subjekteve pa leje që shfrytëzojnë inertet, që të jenë gjobitur apo ndëshkuar subjekte për gjithë këtë krim mjedisor përgjatë lumit Mat.

Më poshtë po ju japim disa pamje të një subjekti që shfrytëzon lirshëm materialet inerte në mënyrë të paligjshme.



Shqetësues mbetet jo vetëm fakti që shtrati i lumit Mat po shkatërrohet në mënyrë sistematike nga subjektet pa lejen përkatëse, që punojnë pa respektuar asnjë kriter, por edhe mosveprimi i institucioneve përgjegjëse që duhej të mos lejonin këtë aktivitet të arritë përmasat e një masakre. Në këto momente subjektet e pajisura me Leje për shfrytëzim inertesh janë vetëm 4 (katër), “Euroteorema Peqin” Sh.p.k (deri më datë 31 Dhjetor 2020), “ANK Construction”

Sh.p.k, “Bardh Konstruksion” Sh.p.k dhe “Salillari” Sh.p.k, por siç duket qartë janë mbi 30 subjekte që shfrytëzojnë inertet e shtratit të lumit Mat.

Ndaj, institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë kërkon që këtij problemi ti kushtohet vëmëndja e duhur dhe të merren masa urgjente nga çdo institucion që ngarkohet me ligj dhe akte nënligjore që të reagojë ndaj këtij problemi me pasoja të pariparueshme, si dhe të merren masat e duhura ndaj çdo institucioni që me mosveprimet e tij bëhet shkak për katastrofën ekologjike që po ndodh me lumin Mat.

Faleminderit për bashkëpunimin!

P R E F E K T I

Gjokë JAKU



Konceptoi: G. Liçi

Miratoi: B. Molla

Konfirmoi: I. Ndoka